

GJYKIMET PRANË DHOMAVE TË SPECIALIZUARA TË KOSOVËS

JANAR - QERSHOR 2024

PËRMBAJTJA

GJYKIMET NË PROCEDURËN PARAPRAKE

GJYKIMET NË SHKALLËN E PARË (SHQYRTIMI KRYESOR)

PROCEDURA NË SHKALLËN E TRETË - GJYKATA SUPREME

Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë (FDHK) në vazhdimësi i monitoron proceset gjyqësore që zhvillohen pranë Dhomave të Specializuara të Kosovës (DHSK). Publikon buletine dhe analiza që lidhen me punën e Dhomave të Specializuara, të cilat i shërbejnë publikut të gjerë për të qenë më të informuar mbi ecurinë e çështjeve gjyqësore.

Në këtë buletin janë paraqitur informatat e përgjithshme mbi ecurinë e gjykimeve para DHSK përgjatë periudhës gjashtë mujore janar - qershor të vitit 2024.

Gjatë kësaj periudhe janë trajtuar pesë (5) raste: Prokurori kundër Hashim Thaçit dhe të tjerëve; Prokurori kundër Pjetër Shalës; Prokurori kundër Salih Mustafës; Prokurori kundër Sabit Januzit dhe të tjerët; Prokurori kundër Isni Kilaj.



GJYKIMET NË PROCEDURËN PARAPRAKE

Prokurori kundër Sabit Januzit, Ismet Bahtijarit & Haxhi Shalës

Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) i ka arrestuar Sabit Januzin dhe Ismet Bahtijarin më 5 tetor të vitit 2023 në Kosovë dhe i ka transferuar në Objektivin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara të Kosovës më 6 tetor të vitit 2023. Aktakuza kundër Januzit dhe Bahtijarit u konfirmua më 2 tetor të vitit 2023 dhe u bë publike më 6 tetor të vitit 2023. Në paraqitjen e tyre të parë më 9 tetor të vitit 2023, të dy të akuzuarit u vetëdeklaruan të pafajshëm lidhur me veprat penale kundër rendit publik dhe pengim të administrimit të drejtësisë dhe administratës publike. ZPS e ka arrestuar Haxhi Shalën më 11 dhjetor të vitit 2023 në Kosovë dhe ai është transferuar në objektivin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara të Kosovës më 12 dhjetor 2023. Aktakuza kundër Shalës është konfirmuar më 4 dhjetor të vitit 2023 dhe është bërë publike më 12 dhjetor 2023. Në paraqitjen e tij të parë më 13 dhjetor 2023, i akuzuari nuk është deklaruar në lidhje me fajësinë ose pafajësinë. Në paraqitjen e mëtejshme më 15 dhjetor 2023, ai është vetëdeklaruar i pafajshëm për veprat e njëjta penale.

Më 12 janar të vitit 2024, pas kërkesës për bashkimin e këtyre dy çështjeve gjyqësore, ZPS-ja e ka dorëzuar propozimin për aktakuzë të përbashkët. Më 16 shkurt të vitit 2024, ZPS-ja, sipas kërkesës së Gjykatësit të Procedurës Paraprake, dorëzoi versionin e ndryshuar të aktakuzës kundër Januzit dhe Bahtijarit, me të cilin korrigjon mbiemrin e Bahtijarit dhe përmirëson qartësinë dhe saktësinë e çështjes. Më 17 maj të vitit 2024, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e ka miratuar kërkesën e ZPS-së për ndryshimin e aktakuzës dhe përfshirjen e pretendimeve të reja faktike vetëm për Januzin dhe Bahtijarin.

Aktakuza e përbashkët u ridorëzua nga ZPS-ja më 27 shkurt të vitit 2024.

Të njëjtit akuzohen në dy pika për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare (pika 1 dhe 2) si dhe në një pikë për frikësim gjatë procedurave penale (pika 3). Sipas aktakuzës së konfirmuar, veprat penale kanë ndodhur midis datës 5 prill të vitit 2023 dhe 12 prillit të vitit 2023, ku të akuzuarit u takuan secili më vete me 'Dëshmitarin 1' për ta nxitur atë që të tërhiqte dëshminë, ose të mos jepte dëshmi fare para Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku këtë ata e bënë përmes përdorimit të kërcënimit të rëndë. Sipas aktakuzës, ata po ashtu, vepruan ndërkohë edhe në bashkëkryerje me individë të tjerë, me synimin për të frikësuar 'Dëshmitarin 1' dhe po ashtu për pengimin e prokurorëve dhe të hetuesve të Zyrës së Prokurorit të Specializuar në kryerjen e detyrave zyrtare.

Gjatë kësaj periudhe raportuese, në këtë rast janë mbajtur edhe dy (2) konferenca për ecurinë e çështjes, në të cilën palët kanë pasur mundësi të shkëmbejnë pikëpamjet e tyre në lidhje me ecurinë e çështjes: qasjen në dokumentacion nga ana e mbrojtjes, çështjen e paraburgimit, dhe çështje të tjera teknike se si do të procedohet në vazhdimësi.

Prokurori kundër Isni Kilajt

Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) e ka arrestuar të pandehurin Isni Kilaj në datën 2 nëntor 2023. I njëjti është arrestuar mbi dyshimin se ka kryer vepra penale kundër administrimit të drejtësisë, përfshirë pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare dhe shkelje të fshehtësisë së procedurës. Kilaj u paraqit për herë të parë para DHSK në datën 4 nëntor 2023.

Hetimet kundër Isni Kilaj ende janë duke vazhduar dhe deri në përfundim të muajit dhjetor 2023

Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) e ka arrestuar të pandehurin Isni Kilaj në datën 2 nëntor 2023. I njëjti është arrestuar mbi dyshimin se ka kryer vepra penale të pengimit të administrimit të drejtësisë, përfshirë pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare dhe shkelje të fshehtësisë së procedurës. Kilaj është paraqitur për herë të parë para DHSK në datën 4 nëntor 2023.

ZPS-ja, më 15 dhjetor të vitit 2023, e ka dorëzuar aktakuzën fillestare kundër Kilajt për konfirmim. Pas dorëzimit të aktakuzës së rishikuar më 11 mars 2024, ZPS, më 2 maj 2024, ka kërkuar pezullimin e aktakuzës së rishikuar për të dorëzuar një version tjetër për konfirmim. Duke marrë parasysh këto zhvillime si dhe prezumimin e pafajësisë dhe të drejtën për liri të Kilajt, gjyqtari i vetëm gjykues Nikola Giju më 15 maj 2024 e zëvendësoi masën e sigurisë së të pandehurit nga paraburgimi në dorëzani dhe lajmërim në polici si dhe kushte të tjera të rrepta.

Prokurori i Specializuar ende nuk ka ngritur aktakuzë në këtë çështje. Aktualisht, Isni Kilaj konsiderohet i dyshuar.

GJYKIMET NË SHKALLËN E PARË (SHQYRTIMI KRYESOR)

Prokurori kundër Hashim Thaçit dhe të tjerëve

Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi, të gjithë me pozita të larta në UÇK, akuzohen nga Prokuroria për krime lufte dhe për krime kundër njerëzimit, për periudhën prej marsit të vitit 1998 deri në shtator të vitit 1999, në disa lokacione në Kosovë dhe në Shqipëri, të cilat pretendohet të jenë kryer nga anëtarë të UÇK-së kundër qindra civilëve dhe personave që nuk merrnin pjesë në luftime. Të gjithë të akuzuarit gjenden në paraburgim që nga nëntori i vitit 2020.

Procedura paraprake në këtë çështje ka zgjatur rreth dy vite e gjysmë. Në fillim të muajit prill të vitit 2023 ka filluar shqyrtimi kryesor me paraqitjen e fjalëve hyrëse të palëve në procedurë dhe që atëherë gjykimi ka vazhduar intensivisht me dëgjimin e dëshmitarëve të propozuar nga prokuroria.

Gjatë periudhës janar - qershor të vitit 2024 janë mbajtur gjithsej 50 seanca gjyqësore, ku janë dëgjuar 35 dëshmitarë të propozuar nga prokuroria.

Në mesin e këtyre dëshmitarëve, 24 prej tyre kanë qenë dëshmitarë të mbrojtur, emrat e të cilëve nuk janë bërë publikë dhe dëshmitë e tyre janë mbajtur kryesisht në seanca private, 9 dëshmitarët e tjerë kanë dëshmuar me identitet të zbuluar dhe në seanca të hapura për publikun, ndërkaq 2 dëshmitarë janë dëgjuar në seancë gjysmë të hapura. Në mesin e këtyre dëshmitarëve ka pasur dëshmitarë të cilët kanë qenë viktimë ose kanë pasur njohuri për ndonjë rast që ndërlidhet me aktakuzën dhe, të njëjtët, kanë dëshmuar për strukturat komanduese të UÇK-së si dhe për qendrat e ndalimit në zona të caktuara. Mes tyre kishte edhe personel të misioneve diplomatike, të cilët kanë qenë në Kosovë me mision gjatë kohës së luftës, si dhe ish-pjesëtarë të KFOR-it.

Prokurori kundër Pjetër Shalës

Pjetër Shala, pjesëtar i UÇK-së, akuzohet nga Prokuroria për krime të luftës për periudhën midis datë 17 maj të vitit 1999 dhe datës 5 qershor të vitit 1999, kundër personave të ndaluar në fabrikën e metalit në Kukës, Shqipëri. Pjetër Shala vazhdon të mbetet në paraburgim që nga arrestimi i tij në mars të vitit 2021.

Gjatë periudhës janar - qershor të vitit 2024 janë mbajtur gjithsej 5 seanca gjyqësore, ku është dëgjuar vetëm 1 dëshmitarë i mbrojtjes, i cili është dëgjuar pa masa mbrojtëse në dy prej këtyre seancave. Mbrojtja e Pjetër Shalës njoftoi më 15 janar 2024 për mbylljen zyrtare të dosjes së tyre. Më 9 shkurt 2024 është mbyllur procedura e paraqitjes së provave në këtë çështje. Nga 15 deri më 17 prill janë dhënë deklaratat përmbyllëse.

Shpallja e aktgjykimit do të bëhet me datë 16 korrik 2024.

PROCEDURA NË SHKALLËN E TRETË – GJYKATA SUPREME

Prokurori kundër Salih Mustafës

Salih Mustafa, komandant i njësitit BIA të UÇK-së, është gjykuar për krime të luftës, të cilat i ka kryer gjatë muajit prill të vitit 1999 në fshatin Zllash/Zlaš të Komunës së Prishtinës/Priština.

Në datën 16 dhjetor të vitit 2022, Dhoma e shkallës së parë e ka shpallur fajtor dhe e ka dënuar me 26 vite burgim për krimet e luftës të ndalimit arbitrar, torturës dhe vrasjes së paligjshme.

Në datën 6 prill të vitit 2023, trupi gjykues lëshoi urdhër për zhdëmtim të viktimave, ku kërkohet të paguhet shuma prej 207.000 € si kompensim për dëmin e shkaktuar ndaj viktimave të kimit.

Kolegji i apelit, me aktgjykimin e shpallur në datën 14 dhjetor të vitit 2023, i rrëzoi gati të gjitha pikat e ngritura në ankesën e parashtruar nga mbrojtja e Mustafës. Duke filluar nga epiteli i konfliktit jondërkombëtar, provat që janë përdorur në gjykim, ligjit më të favorshëm penal, deklaratat e dëshmitarëve, elementi i vrasjes së paligjshme, ndalimi arbitrar e deri te alibia. Pra, të gjitha ankesat e mbrojtjes janë rrëzuar, me përjashtim të pranimit të pjesërishëm të pikave 9F, 9H dhe 9K të dosjes së Apelit. Sipas kolegjit, shkelja e vetme në vendimin e shkallës së parë ka qenë lartësia e dënimit. Rrjedhimisht, Paneli i Apelit zvogëloi dënimin e njësuar të Mustafës nga 26 në 22 vjet burgim, duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim.

Më 14 mars të vitit 2024, Mbrojtja e Salih Mustafës dorëzoi kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë para Gjykatës Supreme.

Gjykata Supreme ende nuk ka vendosur lidhur me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë.

Prokurori kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt

Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj janë gjykuar për vepra penale kundër rendit publik dhe pengimit të administrimit të drejtësisë dhe administratës publike. Që nga arrestimi i të pandehurve në fund të shtatorit të vitit 2020, ndaj tyre ka qenë e caktuar masa e paraburgimit. Pas vendimit të shkallës së dytë, nga fillimi i shkurtit të vitit 2023 të pandehurit kanë qenë në vuajtje të dënimit.

Në datën 18 maj të vitit 2022, trupi gjykues i shpalli fajtorë të dy të akuzuarit për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, frikësim gjatë procedurës penale dhe shkelje të fshehtësisë së procedurës dhe dënoi secilin të akuzuar me nga katër (4) vjet e gjashtë (6) muaj burgim.

Pas apelimit të vendimit të shkallës së parë nga mbrojtja e të pandehurve, Gjykata e Apelit në datën 2 shkurt të vitit 2023 e shpalli aktgjykimin dënues dhe i dënoi me katër (4) vjet e tre (3) muaj burgim. Ky është vendim i formës së prerë.

Në fillim të muajit maj të vitit 2023, mbrojtja e të pandehurve dorëzoi kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë para Gjykatës Supreme. Në datën 18 shtator 2023, Paneli i Gjykatës Supreme hodhi poshtë të dy kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Gjetjet e FDHK:

- Gjatë periudhës raportuese janar - qershor 2024 në rastin Prokurori kundër Hashim Thaçit dhe të tjerëve janë dëgjuar 35 dëshmitarë të propozuar nga prokuroria. Prej tyre, 24 kanë dëshmuar me masat mbrojtëse, identiteti i të cilëve ishte i panjohur dhe kryesisht në seanca të mbyllura për publikun. Po ashtu, janë dëgjuar edhe 11 dëshmitarë, identiteti i të cilëve ishte i njohur për publikun, dhe kryesisht seancat janë mbajtur të hapura për publikun. Rreth 60% të seancave gjyqësore kanë qenë të redaktuara për publikun. Opinioni ka të drejtë t'i dëgjojë deklaratat e dëshmitarëve, por gjithnjë gjykata duhet të kujdeset që vetëm informata të cilat ndikojnë në zbulimin e identitetit të dëshmitarëve të mbrojtur të redaktohen dhe jo e tërë dëshmia e dëshmitarit. Me vazhdimin e kësaj praktike, transparenca e këtyre gjykimeve dhe parimi i publicitetit rrezikon të humbas kuptimin e tij.

- Në DSK gjenden në paraburgim 8 të akuzuar, për të cilët gjykata çdo dy muaj rivlerëson kushtet për caktimin dhe vazhdimin e kësaj mase të sigurisë, duke konstatuar se për këta 8 të akuzuar ekziston baza e rrezikut për ikje, për ndikim dhe/ose pengim të rrjedhës së procedurës penale, apo rreziku se do të përsërisë veprën penale, dhe se masat e sigurisë më të buta do të jenë të pamjaftueshme për të siguruar zbatimin e suksesshëm të procedurës penale. Për dallim në rastin e Isni Kilaj, pasi ZPS tërhoqi aktakuzën e propozuar për konfirmim dhe kërkoi kohë shtesë për të paraqitur një aktakuzë të re, gjykata, si rrjedhojë e këtyre zhvillimeve si dhe të drejtës për liri të Kilajt, ndër faktorët tjerë, urdhëroi zëvendësimin e masës së sigurisë. Gjykata, me vendim ka ndryshuar masën e paraburgimit të Kilajt me masa të tjera më të buta, duke aplikuar masën e paraqitjes në stacionin policorë në Kosovë, dorëzanimin prej tridhjetë mijë (30,000) euro, si dhe masa të tjera të cilat kanë për qëllim parandalimin e ikjes apo shmangies së procesit gjyqësorë penal. Që nga fillimi i punës së DSK, ky është rasti i vetëm i ndryshimit të masës më të rëndë të sigurisë me një masë më të butë.

Ky publikim përkrahet financiarisht nga Departamenti Federal i Punëve të Jashtme të Zvicrës përmes projektit "Avancimi i procesit të pajtimit përmes qasjes përfshirëse dhe holistike ndaj ballafaqimit me të kaluarën në Kosovë" nga organizata "National Endowment for Democracy" përmes projektit të quajtur "Promovimi i dialogut dhe të kuptuarit historik".

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e Fondit për të Drejtën Humanitare Kosovë dhe nuk pasqyron pikëpamjet e Departamentit Federal të Punëve të Jashtme të Zvicrës dhe organizatës "National Endowment for Democracy".



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Federal Department of Foreign Affairs FDFA



NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD



Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë
Fond za Humanitarni Pravo Kosovo
Humanitarian Law Center Kosovo